

Rrjeti për Raportimin e K.O.K.SH
Organized Crime and Corruption and Network in Albania/OCCRNA

1. Informacion Bazë

- **Viti i Themelimit:** Shkurt 2024
- **Statusi Ligjor:** Organizatë joqeveritare
- **Selia Qendrore:** Rr. Shefqet Musaraj 14, H 1, Ap. 19, Tiranë, Shqipëri
- **Faqja e Internetit:** <https://shteg.org/>
- **Email kryesor i organizatës:** lindita.cela@shteg.org
- **Telefoni kryesor i organizatës:** +355693111999

2. Misioni

OCCRNA, e themeluar në shkurt 2024 nga një grup gazetarësh investigativë, është një organizatë jofitimprurëse që ka për mision të zbulojë rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri, të rrisë ndërgjegjësimin qytetar dhe të përmirësojë cilësinë e gazetarisë hulumtuese. Nëpërmjet punës sonë, synojmë të kontribuojmë në forcimin e transparencës, sundimit të ligjit dhe procesit të integritetit evropian të vendit. Me redaksinë e posaçme "Shteg", e cila u krijua në qershor 2024, fokusohemi në investigime të thelluara mbi korrupsionin, krimin e organizuar dhe lidhjet e tyre me institucionet publike, duke bashkëpunuar gjithashtu me media në rajon për të zbuluar rrjete të paligjshme që çënojnë qeverisjen demokratike.

3. Vizioni (Opsionale)

OCCRNA synon një shoqëri ku transparenca, llogaridhënia dhe e drejta për informim janë vlera të padiskutueshme. Vizioni ynë afatgjatë është ndërtimi i një mjedisi mediatik dhe qytetar të ndërgjegjshëm, ku gazetaria hulumtuese luan një rol kyç në ekspozimin e korrupsionit, mbrojtjen e interesit publik dhe forcimin e demokracisë. Kërkojmë të ndikojmë në krijimin e një kulture zero tolerancë ndaj abuzimit me pushtetin dhe burimet publike, duke kontribuar në një Shqipëri më të drejtë, më të barabartë dhe më të përgjegjshme.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

- Investigim gazetaresk (hetim i thelluar i çështjeve me interes publik)
- Verifikim faktesh (fact-checking i informacionit publik dhe mediatik)
- Prodhim multimedia (video dokumentarë, podcast, grafikë informuese dhe përmbajtje të tjera vizuale)

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

Një përshkrim i shkurtër i projekteve, që organizata zhvillon ose ka zhvilluar gjenden si më poshtë:

- **Themelimi i redaksisë investigative "Shteg"** – Me mbështetjen e European Endowment for Democracy (EED), OCCRNA themeloi redaksinë "Shteg", e cila

Rrjeti për Raportimin e K.O.K.SH
Organized Crime and Corruption and Network in Albania/OCCRNA

fokusohet në investigimin e korrupsionit, krimit të organizuar dhe abuzimeve me pushtetin.

- **Mbështetje nga OCCRP për strukturimin dhe trajnimin e stafit** – OCCRP ka kontribuar në ngritjen e redaksisë dhe në trajnimin e gazetarëve të rinj në gazetari hulumtuese.
- **Zhvillimi i bazës së të dhënave “Construction Leaks”** – Në bashkëpunim me GIZ, është ndërtuar një platformë që synon të evidentojë mungesën e transparencës dhe abuzimet në sektorin e ndërtimit.
- **Promovimi i transparencës dhe lufta kundër pandëshkueshmërisë** – Me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), është zbatuar një projekt për të nxitur llogaridhënien dhe për të ekspozuar shkeljet përmes raportimeve investigative.

6. Shtrirja Gjeografike

Organizata jonë ka selinë në Tiranë, por aktivitetet dhe investigimet tona shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë. Punojmë në nivel kombëtar, duke mbuluar çështje mjedisore në zona urbane dhe rurale, sipas problematikave që kërkojnë vëmendje publike dhe hetim gazetaresk.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Lindita Çela

Bordi i Drejtuesve:

Bordi i Drejtuesve i OCCRNA-së përbëhet nga anëtarë me përvojë dhe ekspertizë të lartë në fushën e gazetarisë dhe drejtësisë që përbëhet nga Dorian Matliaj, Koloreto Cukali dhe Ervin Goci si edhe nga Drejtori Ekzekutiv Lindita Çela

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

OCCRNA ka ndërtuar partneritete të rëndësishme me organizata dhe rrjete ndërkombëtare që mbështesin gazetarinë hulumtuese dhe transparencën. Ndër bashkëpunëtorët kryesorë përfshihen OCCRP (Organized Crime and Corruption Reporting Project), me të cilin kemi bashkëpunuar për ngritjen dhe trajnimin e redaksisë hetimore “Shteg”. Jemi gjithashtu të mbështetur nga European Endowment for Democracy (EED), GIZ Albania, dhe National Endowment for Democracy (NED) në zhvillimin e projekteve që synojnë investigimin e korrupsionit, forcimin e gazetarisë cilësore dhe ndërtimin e databazave publike për transparencë. Në nivel rajonal, bashkëpunojmë me media dhe gazetarë nga Kosova, Maqedonia Veriut, Italia dhe Greqia, e për të realizuar investigime të përbashkëta mbi krimin e organizuar dhe lidhjet ndërkufitare të korrupsionit.

9. Ndikimi (Opsionale)

Në vitin e parë të veprimtarisë, OCCRNA ka arritur rezultate të rëndësishme që dëshmojnë ndikimin e punës sonë investigative dhe advokuese.

Platforma “Shteg.org” është bërë burimi ekskluziv i raportimeve investigative në Shqipëri për tema dhe persona që mediat e tjera shpesh shmangen për shkak të presioneve politike ose ekonomike, përfshirë investigime mbi figura të larta si Samir Mane dhe keqmenaxhimin e fondeve të BE-së nga ish-kryetari i Kavajës.



Rrjeti për Raportimin e K.O.K.SH
Organized Crime and Corruption and Network in Albania/OCCRNA

Raportimet tona të plota dhe të detajuara kanë fituar besimin e publikut, me mbi 400,000 vizitor në faqen tone, në gjashtë muajt e parë të lansimit të platformës.

Gjithashtu, OCCRNA dhe Shteg janë pionierë në sigurimin e sigurisë për gazetarët përmes trajnimeve speciale dhe politikave strikte për mbrojtjen e tyre gjatë hetimeve.

Për më tepër, ne zbatojmë standardet më të larta të gazetarisë investiguese, duke u bazuar në burime të shumta dhe kontroll rigoroz të fakteve, që ka ndihmuar në krijimin e një reputacioni të besueshëm dhe të paanshëm.

Një fitore ligjore e rëndësishme u arrit në qershor 2024, kur drejtuesja ekzekutive e OCCRNA-së fitoi një çështje për të drejtën e qasjes në informacion, duke vendosur një precedent të ri për transparencën në Shqipëri.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)

N/A

-